

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrative i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 21.11.2017 mori në shqyrtim çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Adrian Dibra, Sotiraq Bogdani, Tofik Batalli, Xhemal Drazhi, Qazim Selimi, Ramiz Allmuca, Rrapo Nisllaj, Halil Vata, Gani Seci, Gani Islamaj, Maksud Sefa**

PADITUR: **Qendra Personel Rekrutimi Tiranë
Ministria e Mbrojtjes**

OBJEKTI: *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë secilit prej paditësve diferencën midis pagës kalimtare të përfutuar realisht prej tyre dhe masës së pagës kalimtare që e kishin pasur në datën lindjes.*

BAZA LIGJORE: *Ligji "Për statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura" etj.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6351, datë 20.06.2012, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë secilit prej paditësve z.Adrian Dibra, z.Sotiraq Bogdani, z.Tofik Batalli, z.Xhemal Drazhi diferencën midis pagës kalimtare të përfutuar realisht prej tyre dhe masës së pagës kalimtare që e kishin pasur më datën e lindjes së të drejtës për ta përfutuar atë datë 16.11.2009, për periudhën nga data 01.06.2011 deri në datën 19.09.2011.
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë secilit prej paditësve z.Qazim Selimi, z.Ramiz Allmuca, z.Rrapo Nisllaj, z.Halil Vata, z.Gani Seci, z.Gani Islamaj, z.Maksud Sefa diferencën midis pagës kalimtare të përfutuar realisht prej tyre dhe masës së pagës kalimtare që e kishin pasur më datën e lindjes së të drejtës për ta përfutuar atë date 01.11.2010 për periudhën nga data 01.06.2011 deri në datën 20.06.2012.
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë secilit prej paditësve z.Qazim Selimi, z.Ramiz Allmuca, z.Rrapo Nisllaj, z.Halil Vata, z.Gani Seci, z.Gani Islamaj, z.Maksud Sefa nga data 20.06.2012 e në vazhdim deri në përfundimin e afatit ligjor pagesën kalimtare në masën që e kanë pasur në datën e lindjes së të drejtës për ta përfutuar atë date 01.11.2010.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2724, datë 27.12.2013, ka vendosur:

“Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit për gjykimin e çështjes nr. 4358/1337, datë 20.11.2012 dhe dërgimin e kateve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 100, datë 29.01.2014, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 6351, datë 20.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
Rrëzimin e padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kanë ushtruar rekurs paditësat, nënshkruar nga përfaqësuesi i tyre ligjor, avokati, me të cilin kërkohet prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të shkronjës “c” të nenit 63 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr. 100 datë 29.01.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me tjetër trupë gjyqësore.

Tiranë, më 21.11.2017

**Nr. 31003-04494-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr.00-2017-2250 i Vendimit (854)**